



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN
DREJTORIA FINANCES

RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TE BUXHETIT PER VITIN 2020
Në përputhje me nenin 48 te ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “ Per financat e vetëqeverisjes vendore”, Monitorimi dhe raportimi i zbatimit te buxhetit vendor”, nenit 65 te ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise”, nenit 9 pika 1.3 germa Ç, neni 34 pika 6, te ligjit 139/215 “ Per veteqeverisjen vendore” , po ju paraqesim raportin e monitorimit te zbatimit te treguesve te buxhetit per periudhen Janar-Dhjetor 2020.

Bashkia miratoi buxhetin e vitit 2020 me VKB nr.44 date 23.12.2019 dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresen nr.1799/1 date 06.01.2019 .

Buxheti i Bashkisë për vitin 2020 është 396 779 918 lekë, ndër të cilat 166 858 015 lekë nga të ardhurat e veta, 208 840 271 leke nga grandit, 10 074 296 lekë te trashguara nga te ardhurat e vitit 2019, 11 007 336 leke nga grand I trashguar nga viti 2019.

Me poshte tabela.

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2020	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura te vetat	166 858 015	
2	Grandi	208 840 271	
3	Te ardhura te trashguara nga viti 2019	10 074 296	
4	Grand i trashguar nga viti 2019	11 007 336	
5	Paga (600)		173 132 960
6	Sigurime shoqërore (601)		26 187 120
7	Shpenzime operative (602)		122 807 852
8	Transferta (603+604+605+606+609)		31 868 585
9	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë		42 783 400
	Totali i buxhetit	396 779 918	396 779 918

Plani i Buxhetit te Bashkise per vitin 2020

GRAFIKU I TE ARDHURAVE SIPAS BURIMIT

Po te shohim buxhetin e miratuar per vitin 2020 krahesuar me PBA do shohim se ka ndryshime ,keto ndryshime kane ardhur per shkak te ardhurave te trasheguara si dhe per shkak te rritjes se numrit te fuqise puntore ashtu dhe per arsye te paparashikuara qe ndodhen ne vitin 2020 .

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2020 krahasuar me planin e PBA:

në /000 lekë				
Nr.	Emertimi	Buxheti 2020	Buxhei 2020 në PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600,601)	199 320	159 355	-39 965
2	Shpenzime korrente (602,604,609)	154 676	105 544	-49 132
3	Shpenzime investimi (230/231)	42 784	75 143	32 359
	Total gjithsej :	396 780	349 375	-47 405

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe buxhetit vjetore jane bere konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”. Buxheti është hartuar mbi bazën e programeve, kërkesave shkresore nga drejtuesit e tyre, njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare. Ky dokument është hartuar nga Drejtoria Financës. Për hartimin e buxhetit të vitit 2020, është miratuar Grupi i punës për menaxhimin e strategjise (GMS).

Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitin 2020, është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar të bashkisë.

Gjate vitit buxhetor bazuar nga nevojat per ndryshimin e prioriteteve dhe mundesimit te finacimeve të vëna në dispozicion, rezulton se buxheti i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2020, ka ndryshuar, bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, PAK, Ndihma ekonomike, Investime , gjendja civile, etj., të cilat nuk janë pasqyruar ne Buxhet gjithashtu dhe nuke jane pasqyruar ne Aneksat ee Monitorimit te Buxhetit.

Nga struktura e burimeve te planifikura per Buxhetin 2020 nje peshe te konsiderushme zene te ardhurat e planifikuara nga taksat e tarifate vendore. nga realizimi ose jo i tyre varet dhe realizimi i treguesve te ketij buxheti.

Nga totali I te ardhurave te planifikuara per vitin 2020 ,prej 166 858 mije leke, jane realizuar gjithesej 77 650 mije leke. Realizimi I te ardhurave eshte 47 % .

Mose realizimi I te ardhurave ka ardhur kryesishte nga mos realizimi I te ardhurave te planifikuara .

Ku ndikim me te madhe per nga pasha specifike zene te ardhurat nga Ndertesa , Pastrimi , Leje ndertimi etj.

Ky mos realizim I te ardhurave vendore ka ndikuar ne mase te madhe ne mos realizimin e shpenzimeve sipas programeve.

Realizimi I shpenzimeve

Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2020, shpenzimet buxhetore në Bashkinë janë planifikuar në vlerën 396 779 918 lekë dhe realizuar në vlerën 273 323 428 lekë.

Është rakorduar çdo muaj me degën e thesarit si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror. Nga monitorimi mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u vihet re se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës në vijim:

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit per vitin 2020:

TABEL PERMBLEDHESE E SHPENZIMEVE					000/leke
Nr	EMERTIMI	Plan	Fakt	Realiz.	Realizimi ne %
		2020	2020	+/-	Totalit
1	Paga&Sigurime(600,601)	199 320	169 356	29 964	62%
2	Shp. Fuksioni (602-609)	154 677	87 033	67 644	32%
3	Projektme & Investime	42 783	16 935	25 848	6%
	Shuma	396 780	273 323	123 456	

Grafik sipas tabelës së shpenzimeve



Realizimi I shpenzimeve per vitin 2020 I paraqitur ne grafik.

Ne tabelen e mesiperme nuk jane pasqyruar Ndhime Ekonomike , Investimet me fondet e ardhura nga Ministrite e linjes dhe Gjendje Civile.

Fondet e disponueshme me vendim te Keshillit , jane detajuar sipas programeve të miratuara

për Bashkin, konkretisht:

Realizimi i shpenzimeve ne total per Bashkine sipas njesive shpenzuese paraqitet si me poshte:

000/lek

	Prog. buxhetore	Plan	Fakt	Realiz.
		2020	2020	Ne %
01110	Planifikim & Administrim	70 685	53 295	75%
01120	Çeshtje Financ&Fiskale	22 976	18 888	82%
03140	Sherbime Policore	6 690	5 064	76%
03280	Sherbime zjarrefikse dhe mbrojtja civile	17 757	17 643	99%
04220	Bujqesi	10 809	7 910	73%
04240	Uitja dhe kullimi	13 495	4 770	35%
04260	Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	4 600	4 049	88%
04520	Infrastruktura rrugore	45 208	28 074	62%
05100	Menaxhimi I Mbetjeve	47 573	30 848	65%
06140	Ndertimi&Urbanistika	9 482	7 497	79%
06260	Shërbimet publike	27 001	10 580	39%
06440	Ndriçimi I Rrugeve	12 967	9 938	77%
08130	Sporti	14 427	6 619	46%
08220	Kultura	8 812	6 324	72%
09120	Arsimi Baze&Parashkollor	54 299	47 914	88%
09230	Arsimi parauniversitar	4 414	4 240	96%
10140	Kujdes Social PAK	8 680	5 921	68%
10430	Kujdes Social Femijet	6 918	3 750	54%
	TOTAL I SHPENZ.	396 780	273 323	71%

U planifikuan ne total shpenzime per vitin 2020 ne shumen 396 780 mije leke, dhe u shpenzuan ne fakt ne shumen 273 323 mije leke.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i detyrimeve te prapambetura

Bashkia trashëgon detyrime të prapambetura nga ish Bashkia dhe komunat, ku likujdimi i tyre brenda një viti buxhetor është i pamundur dhe për këte arsye kemi bërë grafikun e likujdimit të shtrirë në vite. Krijimi i detyrimeve të reja të vitit është bërë nga vendosja e limitit nga Ministria e Financave në muajt nëntor, dhjetor gjithashtu dhe shpenzime qe u bene per shkak covid-19 . Nuk ka patur raste të mos regjistrimit në kohë të dokumentacionit nga zyra e financës, është bërë kontrolli dhe pastaj pagesa në Degën e Thesarit Elbasan.

Bashkia Peqin per vitin 2020 mbylli 41 317 962 leke detyrime gjithsej. Mos realizimi i detyrimeve eshte mos realizimi i te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

PLANI I VEPRIMIT PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA

VITI 2020DHE PERIUDHA AFATMESME 2021-2023

			Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë katër viteve		
Nr.	Bashkia	Stoku i detyrimit të mbetur deri në dhjetor 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Peqin	41 317 962	26 889 793	9 928 969	4 500 000

Vec sa mesiper Bashkia ka hartuar planini e veprimit per reduktimin dhe mbajtjen nen kontroll te situates Financiare. Per kete:

- Per cdo urdher Prokurim te merret me pare opinionini i nenpunesit zbatues.
- Per cdo kerkes per pune/sherbim apo mallra te zbatohet me rreptesi Udhezimi nr. **nr.2,date 20/01/2020**.
- Cdo Procedure per Prokurim te mos publikohet pa u konfirmuar me pare nga Dega e thesarit.
- Kontratat dorzohen ne afatin ligjore ne drejtorin e finances dhe degen e Thesari.
- Mos te pranohet asnje fature nga operatorët me vlere me te madhe se vlera e percaktuar ne Kontrat per vitin perkates.
- Detyrimet e prapambetura jane bere pjese e PBA-se 2021-2023.

KONKLUSIONE**SI VLERSOHET SITUATA FINANCIARE**

Nga analiza e shifrave dhe faktorve te till si:

- ❖ Gjendjen faktike e buxhetit,
- ❖ Fluksin e te hyrave nga te Ardhurat .
- ❖ Mardhenijet jo korrekte me Kreditorët (Detyrimet)
- ❖ Fondet e obliguuaa per Angazhime buxhetore.
- ❖ Vendime Gjyqesore

Arrim ne konkluzionin se :

- Stoku i detyrimeve financiare eshte % i totalit te shpenzimeve te miratuara
- Situata financiare vlersohet me problem financiare.
- Per vitin 2020, cdo angazhim per shpenzime publike varet nga realizimi I te ardhurave.

Per te dale nga situata kerkohet:

- ❖ Marrjen e masave ligjore ndaj tatim paguesve qe kane krijuar detyrime te rritura progresivishte nga viti ne vite.
- ❖ Zbatim me rigorizitet te kontratave per tokat me qera,deri ne prishjen e tyre.

- ❖ Mos marrja e Angazhimeve te tjera pa likujduar detyrimet (te rejat)
- ❖ Kontroll te shpenzimeve te funksionit si energji, uji e shpenzime administrative.
- ❖ Mose te pranohen fatura per materiale apo sherbime te pa planifikuara dhe te pa mbuluara me fonde.

KRYETARI BASHKISE

Lorenc TOSKU